

GJYKATAT E KOSOVËS - ÇFARË NDRYSHIMESH URGJENTE KËRKOHEN?

Arbëresha RAÇA – SHALA*

Abstrakt:

Ky punim do të trajtojë kuadrin ligjor dhe organizimin e pushtetit gjyqësor në Kosovë nën administrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Nëpërmjet një trajtimi kritik të zhvillimeve në këtë fushe kërkohet t'u jepet përgjigje pyetjeve të ndryshme lidhur me përmirësimin e mëtejshëm të pushtetit gjyqësor dhe me të edhe të administrimit të drejtësisë në Kosovë.

Fjalët kyç: *Pushteti gjyqësor, gjykatat, administrimi i drejtësisë, reformat në sektorin e drejtësisë.*

Drejtësia kosovare, tanimë po kalon në rrugën e tranzicionit drejt një sistemi gjyqësor të pavarur, profesional, të paanshëm dhe shumetnik, i cili do të garantojë gjykim të drejtë dhe të bazuar në ligjet pozitive, si dhe në standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në qershor të vitit 1999, në Kosovë u krijua gjyqësori emergjent qëllimi i së cilës ishte që, derisa të krijoheshin kushtet për funksionimin e gjykatave të rregullta të të gjitha niveleve si dhe derisa të nxirreshin rregulloret për mënyrën dhe kushtet e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Kosova të mos kaplohej nga anarkia dhe kriminaliteti si pasojë e mosfunksionimit të gjyqësisë.

Në atë kohë, rendi dhe siguria e qytetarëve mbahej dhe mbrohej nga KFOR-i, ndërsa më vonë, me ardhjen e policisë ndërkombëtare, u emëruan dhe rreth dhjetë gjyqtarë dhe prokurorë të cilët e luftonin kriminalitetin në tërë Kosovën dhe që me ndihmën e helikopterëve të KFOR-it shkonin nga një qytet në tjetrin për të marrë në pyetje personat që ishin të përfshirë në krimet e kryera¹.

* Departamenti Penal Juridik, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës.

Qysh në fillim të funksionimit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara, si dhe të administrimit të saj nga ana e Përfaqësuesit të Përkohshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, me dekretet emergjente Rregullore e UNMIK-ut Nr.1999/1 dhe 1999/2, u emëruan gjyqtarët dhe prokurorët e parë vendorë, ndërsa më 10 qershor 1999 me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/5, me qëllim të përmirësimit të zbatimit të drejtësisë në Kosovë u themelua Gjykata *ad hoc* e instancës së fundit dhe zyra *ad hoc* e Prokurorit Publik të Kosovës deri në një zgjidhje më të plotë. Gjykata *ad hoc* do të përbëhej nga pesë gjyqtarë, përfshirë edhe Kryetarin e Gjykatës.²

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/7 u krijua Komisioni Këshillëdhënës Gjyqësor për të këshilluar PSSP-në për çështje që kishin të bënin me emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në bazë të rekomandimit të këtij Komisioni, për herë të parë në Kosovën e pasluftës u emëruan 60 gjyqtarët e parë, të cilët i kanë ushtruar funksionet gjyqësore në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr.1999/24 Për Ligjin në Fuqi në Kosovë e datës 12 dhjetor 1999, është përcaktuar se ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

- a) Rregulloret e shpallura nga PSSP-ja dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to;
- b) Legjislacioni në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në bazë të kësaj Rregulloreje, Gjykatat e Kosovës, punën dhe veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në pajtim me “Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta”, ndërsa puna dhe organizimi i brendshëm i gjykatave është rregulluar në pajtim me “Rregullat mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave”.³ Puna e gjykatave në Kosovë, “megjithë vështirësitë dhe të metat ekzistuese përditë e më tepër po arrin ta ushtrojë funksionin e vet në zbatimin e

¹ Kelmendi, Besim, “Sistemi i drejtësisë në Kosovë”, http://www.aukonline.org/repository/docs/Sistemi_i_Drejtësisë_ne_Kosove.doc.

² Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/5, e cila ka hyrë në fuqi më 4 shtator 1999. Më pas janë nxjerrë Rregullorja e UNMIK-ut Nr.1999/6, Rregullorja e UNMIK-ut N. 1999/7, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2000/34.

³ “Ligji mbi Gjykata e Rregullta”, Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, teksti i spastruar, nr.21/78, 49/79, 44/84 dhe 18/87) dhe “Rregulla mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave”, Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, nr.7/81.

ligjit në të mirën e të gjithë qytetarëve, pa dallim etnie, gjinie, feje etj, duke kontribuar kështu në krijimin e një ambienti të sigurtë për zhvillimet shoqërore, politike dhe ekonomike të vendit”. Megjithëkëtë, reformimi i gjyqësorit është domosdoshmëri e kohës, sepse struktura e gjyqësorit të tanishëm nuk mund t’u rezistojë të gjitha ndryshimeve që kanë ndodhur në Kosovë dhe nuk është koherente me nevojat e qytetarëve. Për realizmin e këtij synimi janë bërë dhe po bëhen përgatitjet serioze të cilat përfshijnë: nxjerrjen e një legjislacioni të ri, (Ligji për gjykatat e Rregullta, Ligji për Prokurorinë, Ligji për Noterinë dhe ligje të tjera), ndryshime institucionale dhe strukturimin e ri të gjykatave.⁴

Domosdoshmëria e ndryshimeve legjislative

Nxjerrja e legjislacionit të ri - sidomos Ligji për Gjykata, Ligji për Prokurorinë Publike, Ligji për Noterinë, të cilët ende nuk kanë kaluar në procedurat e miratimit në degën e ekzekutivit, kanë shkaktuar vështirësi në punën dhe veprimtarinë e gjykatave dhe jo vetëm të gjykatave komunale dhe gjykatave të qarkut, por kanë përfshirë edhe Gjykatën Supreme.

Pamundësia e zgjidhjes së rasteve dhe mangësia në legjislacionin e tanishëm të rishqyrtimeve gjyqësore të vendimeve administrative janë shprehur edhe në Gjykatën Supreme të Kosovës. Grumbullimi i rasteve ligjore administrative që presin zgjidhje pranë kësaj Gjykate në vitin 2006 ka qenë 2164 raste, ndërsa numri i rasteve të pranuar në periudhën janar – dhjetor 2006 ka qenë 4856 raste. Sipas kornizës së ardhshme ligjore, Gjykata Supreme duhet të funksionojë si gjykatë e apelit dhe të ketë juridiksion vetëm për të shqyrtuar legjitimitetin e vendimeve të marra nga gjykata e shkallës së parë, sa i përket rasteve administrative.⁵ Sistemi i gjykatave duhet të ndryshohet për të qenë më efikas dhe për të ofruar standard më të lartë të drejtësisë, pasi sistemi i tanishëm është i ndërlikuar dhe me shumë instanca – shkallë të vendosjes apo rishqyrtimit dhe i

⁴ Buletini i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, nr. 9, “Reformimi i gjyqësorit në Kosovë është domosdoshmëri e kohës”, Prishtinë, faqe 2-3.

⁵ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Sektori për Monitorimin e Sistemit Juridik, “Raporti i parë për sistemin e drejtësisë administrative në Kosovë”, prill 2007, faqe 16 dhe 24.

shumëllojshëm, sistem ky i damkosur edhe nga vonesat procedurale të vjetruara dhe me grumbullim të rasteve.⁶

Prandaj, gjyqësori kosovar sot vuan nga mungesa e ligjeve të reja dhe aty-këtu, edhe nga mungesa e zbatimit të ligjeve që janë në fuqi.

Domosdoshmëria e ndryshimeve institucionale-strukture

Ndryshimet institucionale të cilat do të jenë rrjedhojë e ndryshimeve legislative do të përfshijnë ndryshimet edhe në strukturën e gjykatave. Sistemi i tanishëm gjyqësor përfshin: gjykatat komunale, gjykatat e qarkut, Gjykatën Ekonomike të Qarkut dhe Gjykatën Supreme. Në strukturën aktuale të gjykatave gjithashtu përfshihen edhe gjykatat komunale për kundërvajtje dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje. Në këtë strukturë nuk bën pjesë Gjykata Kushtetuese e Kosovës, “e cila nuk pritet të krijohet para vjeshtës së këtij viti. Për këtë tashmë është duke u hartuar ligji për institucionin më të lartë të gjyqësisë, i cili, në bazë të dinamikës, pritet t’i dorëzohet Kuvendit në fillim të shtatorit”.⁷

Mënyra e re e organizimit të gjykatave do të përshijë strukturimin e gjykatave sipas standardeve evropiane. Disa nga propozimet që janë përfshirë në projektligjin për gjykatat është edhe “shuarja” e gjykatave për kundërvajtje apo kalimi i kompetencave të tyre në gjykatat komunale apo gjykatat themelore (varësisht nga ajo se si do të përcaktohet me draftin përfundimtar të ligjit për gjykatat). Gjithashtu është propozuar që disa nga çështjet e kundërvajtjeve të cilat janë të pakontestueshme do të duhej të shqyrtoheshin nga bashkëpunëtorët profesionalë të gjykatave komunale. Në këtë draft janë përfshirë Njësia për Inspektim Gjyqësor dhe Njësia e Auditimit Gjyqësor. Përveç kësaj, disa nga shërbimet apo njësitë institucionale të cilat kanë qenë në kuadër të gjykatave komunale do të kalojnë në zyrat e noterisë.

⁶ Tunheim, R.John, “Një agjendë për reformën e sistemit të drejtësisë në Kosovë”, Drejtësi, Focus Kosovo-law, justice and public safety, <http://www.unmikonline.org/albanian/pub/focuskos/feb05/focusklaw1.htm>.

⁷ I.Krasniqi, Kosova ende pa Gjykatë Kushtetuese, “Kushtetuta pa mbrojtës deri në vjeshtë”, Kosova Sot, nr.3174, 15 korrik 2008, faqe 3.

Domosdoshmëria e aplikimit të teknologjisë informative

Disa nga çështjet administrative që lidhen ngushtë me aplikimin e teknologjisë informative janë një nga nevojat e menjëhershme që duhet të zbatohen në sistemet e reformuara gjyqësore. Krijimi i një baze të dhënash elektronike, sado e thjeshtë, deri sa të fillojë zbatimin i bazave të dhënave elektronike të sofistikuar duhet të zbatohet nëpër gjykata sa më shpejt që të jetë e mundur.

Spektori i Auditimit Gjyqësor, që ka funksionuar në kuadër të Njesisë së Inspektimit Gjyqësor, në vitin 2006, gjatë punës në terren, e ka konstatuar këtë ngecje të sistemit gjyqësor dhe e ka emërtuar si “pikë të dobët” në sistemin gjyqësor të Kosovës. Kjo e metë ndikon fuqishëm në efektivitetin e procedurës së hyrjes dhe regjistrimit të shkresave në gjykatë dhe që automatikisht ndalon korrupsionin e mundshëm në drejtim të shqyrtimit të shkresave që arrijnë në gjykatë pas afatit të paraparë ligjor.

Në konstatimet e tyre është vënë në pah se edhe një çështje e natyrës teknike ndikon fuqishëm më anën përmbajtësore të punës dhe veprimtarisë së gjykatave. Regjistrimi i shkresave hyrëse në mënyrë elektronike pa mëdyshje do shmangë apo zvogëlojë deri në minimum çdo mundësi eventuale të “futjes” jo të rregullt të shkresave në gjykatë, sidomos mundësia e dorëzimit të parashtrësve pas afateve të parapara ligjore. Gjithashtu, me funksionimin e sistemit elektronik do të shfrytëzoheshin maksimalisht njohuritë dhe aftësitë e nëpunësve të gjykatave. Punët administrative do të mund të kryheshin me metoda oportune dhe mjete teknike moderne⁸

Identifikimi i nevojave të sistemit gjyqësor, ngecjeve të cilat parandalojnë ndryshimet

Monitorimi i drejtësisë kosovare është kryer nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), që nga viti 1999. Kjo organizatë ka analizuar nevojat e drejtësisë kosovare dhe ka vënë në pah mangësitë dhe shqetësimet e përgjithshme dhe substanciale

⁸ Drafti i raportit të pestë të auditimit gjyqësor me temën “Rishikimi i praktikave gjyqësore lidhur me pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e shkresave në gjykatat komunale”, dhjetor 2006- janar 2007.

që janë identifikuar gjatë procesit të monitorimit të procedurave gjyqësore. Disa nga ato janë:

Sipas raportit⁹ numri jo i duhur i gjyqtarëve porotë që janë të pranishëm gjatë procedurave gjyqësore, paraqet shkeljen e së drejtës për gjykim para trupit gjykues ashtu siç parashihet me ligj, prandaj në këto raste, shkelja ndodh kur gjykata nuk funksionon në bazë të ligjit të aplikueshëm procedural.

Pritjet e gjata për procedimin e lëndëve gjyqësore (marrja në punë) dhe grumbullimi i lëndëve ka qenë i pranishëm jo vetëm në gjykata komunale, por edhe në instancat më të larta. Sipas raportit,¹⁰ rishqyrtimi gjyqësor i akteve administrative është i ngadalshëm dhe numri i rasteve administrative të pazgjidhura që presin në Gjykatën Supreme është i rritur, pasojë e numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve, vetëm dy nga gjykatësit e ndihmuar nga dy zyrtarët ligjorë gjykojnë të gjitha rastet e ligjit administrativ dhe veç asaj, asnjë gjykatë në Kosovë nuk është e specializuar në rastet ligjore administrative. Aq më tepër, raporti thekson menaxhimin e dobët të rasteve, që si pasojë kanë shkaktimin e vonesave apo shterje të panevojshme të procedurave dhe rrezik për humbjen e shkresave.

Hulumtimi i disa shkresave penale dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në seancat gjyqësore penale, ka zgjuar interesim për t'iu qasur të dhënave statistikore të cilat kanë qenë të bazuara në raportet vjetore të gjykatave lidhur me kohëzgjatjen e procedurave penale. Ky hulumtim ka përfshirë kohëzgjatjen e vendosjes së lëndëve gjyqësore që lidhen me veprat penale kundër martesës dhe familjes në periudhën kohore 2002-2005¹¹ duke e përfshirë

⁹ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Sektori për Monitorimin e Sistemit Juridik, “Raport tremujor”, janar–mars 2007, faqe 8 dhe 9.

¹⁰ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Sektori për Monitorimin e Sistemit Juridik, “Raporti i parë mbi sistemin e drejtësisë administrative në Kosovë” prill 2007, faqe 16.

¹¹ Hulumtimi është bazuar në: “Raporti vjetor mbi llojet e veprave penale dhe të dënuarit për 2002”, Departamenti i Administratës Gjyqësore, Ministria e Shërbimeve Publike, Prishtinë, shkurt 2003; “Raporti Vjetor 2003”, Lëndët e kryera për veprat penale – personat e akuzuar dhe të dënuar për ato vepra, Departamenti i Administratës Gjyqësore, Ministria e Shërbimeve Publike Prishtinë, shkurt 2004; “Lëndët e kryera për veprat penale, personat e akuzuar dhe të dënuar për vitin 2004”, Departamenti i Administratës Gjyqësore, Ministria e Shërbimeve Publike, Prishtinë, shkurt 2005; dhe “Raporti Statistikor mbi lëndët e zgjidhura penale”, periudha 01/01/2005 deri më 31/12/2005, Departamenti i Administratës Gjyqësore.

edhe dhunën në familje. Koha relativisht e gjatë e zgjidhjes së rasteve penale, madje katër nga rastet e dhunës në familje janë zgjidhur në periudhën kohore mbi 3 vjeçare, pasqyrojnë ngecjet e sistemit gjyqësor në ndarjen e drejtësisë penale, raste këto që nuk durojnë vonesa. Rastet e caktuara kanë vënë në pikëpyetje edhe ndarjen e drejtësisë penale në një kohë të arsyeshme. Kjo sidomos kur flitet për veprën penale të bashkëjetesës me personin e mitur. Nëse procedurat penale zgjasin shumë, atëherë ndodh parashkrimi i ndjekjes penale dhe kështu kryesi lirohet nga ndjekja dhe për veprën e caktuar nuk dënohet; apo rastet kur kryesit i është shqiptuar dënimi dhe vendimi ka marrë formën e prerë, mirëpo procedura e ekzekutimit të dënimit është përcjellë me zvarritje të gjata dhe kjo ka ndikuar që kryesi nuk e ka vuajtur dënimin e merituar, pasi instituti i parashkrimit ka gjetur zbatim.

Sipas standardeve të caktuara për marrjen në punë të lëndëve penale, disa nga veprat penale të kryera në Kosovë, është dashur që të procedohen dhe të zgjidhen me prioritet.¹² Në atë grup të veprave penale janë përfshirë: trafikimi me qenie njerëzore, dhuna në familje, korrupsioni etj, por që procedurat gjyqësore penale kundër kryesve të veprave penale e të cilat kanë qenë të lidhura ngushtë me përmbushjen e “standardit të parë – sundimit të ligjit”, gjykatat e Kosovës, nuk ia kanë dalë që ato raste t’i zgjidhin për një kohë optimale. Në krijimin e kësaj gjendjeje ka ndikuar dhe ka qenë i “plotësuar” edhe me vështirësitë e natyrës teknike si hapësirat e sallave-dhomave të gjykimeve dhe bartja apo zhvendosja e gjyqësorit nga një objekt në një objekt tjetër dhe sidomos mungesa e theksuar e kuadrit profesional – gjyqtarëve. Emërimi i gjyqtarëve të rinj cili ka qenë simbolik për nevojat e gjyqësorit të Kosovës, nuk ka arritur të përmirësojë në masë të madhe gjendjen sa i përket e zgjidhjes së rasteve penale në kohë të arsyeshme.

Shqetësimet e ekipit të monitorimit të OSBE-së për mosfunksionimin e plotë të gjykatave si organe të pavarura, posaçërisht në çështjet e paraburgimit e që lidhen me ndërhyrjet ekzekutive dhe legjislative nga ana e PSSP-së dhe KFOR-it, kanë pasuar me

¹² Në Kosovë, në vitin 2003 Bashkësia Ndërkombëtare ka përcaktuar të ashtuquajturat “STANDARDET PËR KOSOVËN”. Standardi i parë “sundimi i ligjit- qasja e barabartë në gjyqësi”, përfshirë edhe punën e gjykatave në zgjidhjen e rasteve gjyqësore.

rekomandime për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/64, ashtu që gjykatësit duhet t'u përmbahen të gjitha garancive procedurale për përjashtimin e shkaqeve të paanshmërisë¹³.

Në takimet e përbashkëta të Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës, janë identifikuar problemet që e kanë kapluar gjyqësorin në punët e përditshme të tij. Ndër ato çështje janë përfshirë:

- vonesat në emërimin e gjykatësve të rinj, mungesën e fleksibilitetit në transferimin e gjykatësve në gjykatat ku mungojnë gjyqtarët, mospërfshirja e shoqatës së gjykatësve të Kosovës në emërimin e gjykatësve të rinj;
- procedimin e ngadalshëm të rasteve, raste të papërfunduara me vite të tëra, vonesa në marrjen e vendimeve për rastet përkatëse;
- mungesa e publikimit të komentareve për interpretimin e ligjeve ekzistuese, mungesa e ligjit për gjykatat dhe akteve nënligjore dhe çështje të tjera.¹⁴

Në ditët e sotme jemi dëshmitarë të situatës kur në sistemin e drejtësisë ka ndikim të drejtpërdrejtë politika, kjo rrethanë është shprehur menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në muajin mars 2008 dhe si pasojë ka mosfunksionimin e rregullt të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut në Mitrovicë, duke përfshirë edhe Prokurorinë Komunale dhe atë të Qarkut po në Mitrovicë, të cilat gjenden në pjesën veriore të Kosovës.¹⁵ Ndërtesa ku këto organe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre është uzurpuar nga ana e ekstremistëve serbë dhe në këtë mënyrë i tërë dokumentacioni është bllokuar në zyrat e ndërtesës. Gjendja alarmante e krijuar nga mosfunksionimi adekuat i këtyre organeve të drejtësisë duket se e ka vështirësuar edhe më tej punën e gjyqësorit të Kosovës. Tani për tani, në këto prokurori dhe gjykata procedohen pa zvarritje vetëm rastet e natyrës urgjente.

¹³ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundim të së drejtës, "Kosovë- shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale shtator 2001-shkurt 2002", tema – pavarësia e gjyqësisë, faqe 56 dhe 57.

¹⁴ "Gjykatësit dhe avokatët diskutojnë problemet mbi sundimin e ligjit në Kosovë", diskutimet e përfunduara në Qershor 2007, 2007-2008, programet e ABA/Iniciativa për sundimin e ligjit në Kosovë-USAID.

¹⁵ Dy Prokuroritë Publike – Komunale dhe e Qarkut si dhe Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, janë "vendosur" në objektin e Gjykatës Komunale në Vushtri.

Shtrohen pyetjet: A mund të pritet një përmirësim i shpejtë i situatës? Dhe: a do të ndikojë reformimi i sistemit gjyqësor në rezultatet e punës së gjyqësorit. Përgjigja duhet të jetë e matur në pyetjen e parë sa i përket kohëzgjatjes së përmirësimit të situatës, por në pyetjen e dytë përgjigja është pa mëdyshje pozitive, pasi zbatimi i reformave në gjyqësor do të përcillet me rezultate në punë dhe funksionim adekuat mbase sado të ngadalshme të jenë ndryshimet, ato do të sjellin përparim. Gjykatave të Kosovës, domosdoshmërisht iu nevojitet:

- Pavarësia e plotë e gjyqësorit nga ekzekutivi dhe ndikimet politike në vend;
- Përsheptimi i nxjerrjes dhe miratimi i Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Prokurorinë Publike;
- Shtimi i numrit të gjyqtarëve profesionalë dhe zyrtarëve ligjorë. (Së paku një zyrtar ligjor-bashkëpunëtor profesional të ndihmojë dy gjyqtarë të një gjykate);
- Procedurat e ri-emërimit të gjyqtarëve aktualë dhe emërimi i gjyqtarëve të rinj t'i nënshtrohen shqyrtimit të “së kaluarës së tyre” apo siç emërtohet “background check” (kontrolli i historisë të personalitetit);
- Përkrahja dhe bashkëpunimi i Gjykatave me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Njësinë e Inspektimit Gjyqësor e sidomos me Njësinë e Auditimit Gjyqësor, qëllimi i së cilës është gjetja e pikave të dobëta në sistemin gjyqësor dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e tij.
- Administrata e gjykatës të kujdeset për shpërndarjen adekuate të lëndëve tek gjykatësit dhe implementimin e teknologjisë informative - programeve elektronike për regjistrimin e lëndëve përkatësisht hyrjen e shkresave në gjykata;
- Vazhdimi i programeve të avancuara të edukimit ligjor për gjykatësit e rinj dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës, të fillojë me programet e specializuara për gjykatësit me përvojë të cilët shqyrtojnë sidomos çështjet administrative.